

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIC OF KOSOVA QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA MINISTRIA E ARSIMIT E SHKENCËS DHE E TEKNOLOGJISË MINISTARSTVO OSVETENIA NAUKI I TEHNOLOGIJE MINISTRY OF EDUCATION SCIENCE & TECHNOLOGY SEKTOR I ARCHIVËS-SEKTOR ARCHIVE-ARCHIVE SECTOR	
Njësia Org. Org. Jedinia Org. Unit.	Nr. Prot. Broj Prot. Prot. No.
0143	1086
Nr. faqevra Br. stranica No. pages	Data: Datum: Date
2	07/05/2020
Prishtinë / a	



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIC OF KOSOVA AGJENCIA E AKREDITIMIT E KOSOVËS AGENCIJA ZA AKREDITOVANJE KOSOVA KOSOVO ACCREDITATION AGENCY	
Nr. Prot. Broj Prot. Prot. No.	Data: Datum: Date
404/2020	07/05/2020
Prishtinë / a	

Republika e Kosovës
 Republika Kosova-Republic of Kosovo
 Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, /Ministarstvo za Obrazovanje Nauku, Tehnologiju i Inovacije, /Ministry of Education Science, Technology and Innovation

Kabineti i Ministres/Kabinet Ministra/ Cabinet of the Minister

Ref: 35/01B
 Datë: 07.05.2020

Ministrja e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, në mbështetje të nenit 8, 10 dhe 11 të Ligjit nr. 06/L -113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (Gazeta zyrtare nr. 7 /01 mars 2019), nenit 6 dhe 7 të Ligjit nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 19, 9 shtator 2011), nenit 8 paragrafi 1, nënparagrafi 1.4 i Rregullores nr.02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (22.03.2011), dhe vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.01/07 të datës 11.03. 2020, nxjerr:

Vendim

për lejimin e vlerësimit të jashtëm të akreditimit të institucioneve të arsimit të lartë përmes video konferencës

1. Ky Vendim rregullon procedurat e vlerësimit të jashtëm nga vlerësuesit ndërkombëtarë përmes video konferencës, gjatë periudhës, në të cilën janë në fuqi masat e aplikuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës sipas paragrafit 1.2 të vendimit Nr.01/07, të datës 11.03.2020, me qëllim të menaxhimit të rrethanave emergjente të krijuara nga pandemia COVID 19, me të cilin ndër të tjera është pezulluar përkohësisht transporti ajror dhe tokësor ndërkombëtar duke pamundësuar ardhjen e vlerësuesve ndërkombëtarë për procesin e akreditimit dhe ri-akreditimit në Republikën e Kosovës.
2. Gjatë periudhës në të cilën janë në fuqi masat e aplikuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës përmes vendimit Nr.01/07 të datës 11.03.2020, lejohet vlerësimi i institucioneve që kanë aplikuar për akreditim nga vlerësuesit ndërkombëtarë përmes video konferencës, si masë zëvendësuese e realizimit të vizitës në institucionin e arsimit të lartë, siç është përcaktuar me nenin 15 paragrafi 1 pika 1.2 të Udhëzimit Administrativ 15/2018, për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë (IAL) në Republikën e Kosovë.
3. Në rastet e vlerësimit të akreditimit nga vlerësuesit ndërkombëtarë përmes video konferencës sipas dispozitave të pikës 2 të këtij Vendimi, Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA) dhe vlerësuesi ndërkombëtar duhet t'i përmbushin të gjitha përgjegjësit dhe obligimet e parapara sipas Udhëzimit Administrativ 15/2018, për Akreditimin e IAL-ve.

4. Vlerësimi i akreditimit nga vlerësuesit ndërkombëtarë përmes video konferencës sipas dispozitave të pikës 2 të këtij vendim duhet të aplikohet në mënyrën restriktive, ashtu që kjo metodë aplikohet me prioritet për rastet kur mos-aplikimi i metodës së vlerësimit të përcaktuar me dispozitat 2 të këtij Vendimi, siç janë IAL-të që nuk janë akredituar gjatë vitit akademik 2018-2019, do të mund t'u shkaktonte dëm të madh dhe atë me efekt të humbjes së përhershme të akreditimit institucional.
 - 4.1. Përveq rasteve të përcaktuara në dispozitën e pikës 4 të këtij Vendimi, lejohet vlerësimi përmes video konferencës edhe në rastet tjera, me kusht që të respektohen dhe përmbushen kriteret dhe parimet e përcaktuara me pjesën II: Standardet dhe udhëzimet për sigurimin e jashtëm të cilësisë të ESG 2015.
5. Shuma e honorarit të vlerësuesve të jashtëm për vlerësimin përmes video konferencave përcaktohet si në vijim: 600 Euro për përgatitjen e vizitës (video konferencës), 600 Euro për secilën ditë të vizitës (video konferencës) dhe 600 Euro për hartimin e raportit.
6. Ky Vendim vlen deri sa në fuqi të jetë vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.01/07, i datës 11.03.2020 apo ndonjë vendim tjetër i cili e ndalon transportin ajror ndërkombëtar të udhëtarëve duke pamundësuar ardhjen e vlerësuesve ndërkombëtar për procesin e akreditimit dhe ri-akreditimit në Republikën e Kosovës.
7. Obligohet Agjencia e Kosovës për Akreditim që të zbatoj këtë Vendim.
8. Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Hykmete Bajrami

Ministre në detyrë/MASHTI



Vendimi i'u dërgohet

1. *Kabinetit të Ministres*
2. *AKA-së*
3. *Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm*
4. *Arkivit*